



BULETIN MUJOR

SHKURT 2026



PËRMBAJTJA

- Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet AKSK dhe British Council për zhvillimin e kapaciteteve në sigurinë kibernetik
- Viojnë takimet për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturave kritike dhe të informacionit
- Nis Cybersecurity Talent Club: Një hapësirë e re për zhvillimin e talentëve
- AKSK dhe GIZ Albania nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi për forcimin e sigurisë kibernetike

Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet AKSK dhe British Council për zhvillimin e kapaciteteve në sigurinë kibernetik



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe British Council nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi, duke vendosur një kuadër bashkëpunimi afatgjatë në zhvillimin e aftësive, mbështetjen e politikave dhe rritjen e kapaciteteve në sigurinë kibernetike.

Memorandumi synon të thellojë bashkëpunimin në programe trajnimi, iniciativa për zhvillimin e talentëve dhe kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike, me fokus të veçantë në krijimin e mundësive konkrete për vajzat dhe gratë që synojnë të zhvillohen profesionalisht në këtë sektor.



Viojnë takimet për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturave kritike dhe të informacionit

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve për infrastrukturën kritike dhe infrastrukturën e rëndësishme të informacionit të reja të shtuara në listë, u zhvilluan sesione informimi me fokus forcimin e mekanizmave të sigurisë kibernetike dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore. Gjatë këtyre angazhimeve u trajtuan çështje që lidhen me menaxhimin dhe vlerësimin e rrezikut kibernetik, identifikimin dhe reagimin ndaj alerteve të sigurisë, vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemeve, si dhe procedurat për raportimin dhe menaxhimin e incidenteve. Këto takime të përjavshme, të mbështetura nga DCAF, kanë për qëllim rritjen e nivelit të gatishmërisë institucionale, standardizimin e proceseve dhe garantimin e një qasjeje të strukturuar në mbrojtjen e sistemeve dhe shërbimeve thelbësore.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039



BULETIN MUJOR

SHKURT 2026



Nis Cybersecurity Talent Club: Një hapësirë e re për zhvillimin e talenteve

Gjatë muajit shkurt u lançua Cybersecurity Talent Club, një iniciativë e AKSK që synon të krijojë një hapësirë për të rinjtë me interes në sigurinë kibernetike. Takimet e para u fokusuan në ndërtimin e kulturës së sigursë digjitale, duke trajtuar çështje si higjiena kibernetike, menaxhimi i kredencialeve dhe rreziqet që lidhen me sjelljet e pasigurta në mjediset profesionale. Përmes diskutimeve dhe analizës së situatave konkrete, pjesëmarrësit u njohën me sfida reale dhe qasje praktike për adresimin e tyre.

Sesionet shërbyen gjithashtu si platformë për bashkëpunim dhe shkëmbim idesh mes studentëve, profesionistëve dhe përfaqësuesve të biznesit, duke hedhur bazat për një rrjet të ri bashkëpunimi në këtë fushë.

AKSK dhe GIZ Albania nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi për forcimin e sigursë kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe GIZ Albania nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigursë kibernetike, me fokus zhvillimin e Laboratorit të Sigursë Kibernetike për trajnim, simulim dhe shkëmbim ekspertize në nivel kombëtar dhe rajonal.

Kjo marrëveshje është një hap i rëndësishëm drejt arritjes së objektivave strategjike, duke krijuar kushtet për përkthimin e ideve dhe prioritetëve të përbashkëta në plane veprimi konkrete, si dhe për forcimin e bashkëpunimit rajonal në sigurinë kibernetike, në funksion të ndërtimit të një mjedisi digjital më të sigurt në Ballkanin Perëndimor.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039